

## 1. Informacion i përgjithshëm

Mak Albania Shpk është krijuar në vitin 1994, me vendim gjykate Nr. 4453, date 19 Maj 1994. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe nga statuti i saj.

Shoqëria ka NIPT J61821059A.

Selia e shoqërisë është Sheshi Italia, Ambjenti me Nr. pasurie 7/41, zona kadastrale 8160, Tiranë.

Në datë 05.02.2018 kuotat e shoqërisë janë blerë nga kompania Kastrati Group e cila zoteron 100% të kapitalit të shoqërisë.

Administratori i shoqërisë në datë e lëshimit të pasqyrave është Shefqet Kastrati.

Në 31 dhjetor 2022 shoqëria ka 1 punonjës (2021: 1).

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### 2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë.

### 2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe moneda funksionale e Shoqërisë.

### 2.5. Vlerësimet dhe gjykime

Paraqitura e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësimet dhe supozimet që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financier, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimesht dhe bazohen në eksperiençën e mëparshme dhe faktorë të tjera duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësimet dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë pëershruar më poshtë.



**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

**2.5. Vlerësimë dhe gjykime (vazhdim)**

**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimë bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaximi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

**2.5.2. Provizonet**

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%. Në tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaximi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

**3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2022	2021
EUR/LEK	114.23	120.76
USD/ LEK	107.05	106.54

**3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përvèç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitit finansiar ose kur shoqëria transferon aktivin finansiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.



**3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

**3.2. Instrumentat finanziarë (vazhdim)**

*Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

*Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

*Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferençë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

*Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

*Të tjera*

Instrumenta të tjera jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

*Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

*Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivitë që mund të maten në mënyrë të besueshme.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interest.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.2. Instrumentat finansiarë (vazhdim)

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njoftes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuase. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale

##### i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me vlerën e drejtë duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-nđërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendje e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.


Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.



**3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

**3.4. Aktive afatgjata material (vazhdim)**

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2022 dhe 2021 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Norma e amortizimit %		Metoda e llogaritjes
	2022	2021	
Ndërtesa dhe instalime	5	5	
Makineri e pajisje	20	20	
Mjete transporti	20	20	Mbi Vlerën e mbetur
Mobilje orendi	20	20	
Pajisje elektronike	25	25	

Amortizimi nuk aplikohet për tokën dhe punimet në proces që nuk janë në funksionim.

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**3.5 Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vêllim) të blerë.

**3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimitarës ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përvëç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimitaritë financiare dhe investuese.

**3.7 Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetem qira operative.

**3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.



### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.9 Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vtit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshmë të vtit, duke aplikuar normat tatile more në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 është 15% (2021: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimit të pagueshmë (apo të rikuperueshmë) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijojnë për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatile more. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatile more në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatile more.

Gjendjet e shtyra tatile more maten me normat tatile more në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferençat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatile more e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatile more të shtyra për diferençat e përkohshme të zbritshme registrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshmë në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

#### **3.10 Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjisacionin shqiptar. Autoritetet Fiscale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

#### **3.11 Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### **3.12 Prozionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Prozionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe përisqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Prozionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, prozionet rimerren.

#### **3.13 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënimë të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënimë për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Arka	-	-
Banka	3,876	531,596
	<b>3,876</b>	<b>531,596</b>

**5. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

Lëvizjet në zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Llogari te arketueshme tregtare	23,172,960	23,501,337
Zhvleresimi i llogarive te arketueshme	(17,818,771)	(17,818,771)
	<b>5,354,189</b>	<b>5,682,566</b>

**6. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
TVSH ne dogane	97,706	97,706
Tatim fitimi	891,513	891,513
TVSH e arketueshme	81,586	50,613
	<b>1,070,805</b>	<b>1,039,832</b>

**7. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura**

Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Autostar	82,330	82,330
Kastrati Residences	769,212	248,112
Shmel Express	458,275	458,275
	<b>1,309,817</b>	<b>788,717</b>



**8. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Llogari të pagueshme tregtare	19,958,460	19,958,460
	<b>19,958,460</b>	<b>19,958,460</b>

**9. Llogari të pagueshme ndaj palët e lidhura**

Llogaritë e pagueshme ndaj palët e lidhura më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Kastrati Hotels and Tower	1,073,956	762,663
AUTO STAR ALBANIA	142,921	142,921
Shmel Express	2,402,000	2,402,000
	<b>3,618,877</b>	<b>3,307,584</b>

**10. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 detajohen si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore TAP	1,157	883
Tatimi mbi vlerën e shtuar	-	-
	<b>1,157</b>	<b>883</b>

**11. Kapitali themeltar**

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2022</b>			<b>31 dhjetor 2021</b>		
	<b>Kuotat</b>	<b>Vlera nominale</b>	<b>%</b>	<b>Kuotat</b>	<b>Vlera nominale</b>	<b>%</b>
Kastrati Group	1	9,628,751,750	100%	1	9,628,751,746	100%
	<b>1</b>	<b>9,628,751,750</b>	<b>100%</b>	<b>1</b>	<b>9,628,751,746</b>	<b>100%</b>

**12. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>
	<b>-</b>	<b>206,760</b>
Te ardhura nga aktiviteti	<b>-</b>	<b>206,760</b>
	<b>-</b>	<b>206,760</b>

**13 Shpenzime personeli**

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>
Pagat e personelit	-	546,219
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	13,124	103,323
	<b>13,124</b>	<b>649,542</b>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2022 është 1(2021: 1).

**14. Shpenzime të tjera të shfytëzimit**

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>
Shpenzime komisione bankare	17,392	88,785
Taksa	105,998	348,666
Gjoba dhe demshperblime	-	30,712
Provizione	-	-
Shpenzime te tjera	154,869	163,589
	<b>278,259</b>	<b>631,752</b>

**15. Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financier të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>
Fitim nga kursi i këmbimit	-	(157,569)
Humbje nga kursi i këmbimit	-	(90,165)
	<b>-</b>	<b>(247,734)</b>



**16. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
<i>Fitimi para tatimit</i>	(615,595)	(1,322,268)
Total shpenzime të panjohura	-	30,712
Gjeba dhe demshperblime	-	30,712
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<b>(615,595)</b>	<b>(1,291,556)</b>
Humbje fiskale e mbartur	(26,814,650)	(25,523,094)
<i>Tatim fitimi @15%</i>	<hr/> <hr/> <b>(615,595)</b>	<hr/> <hr/> <b>(1,322,268)</b>

**18. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

